



Dokumenti i kuvendit komunal  
Vlora Mjekiqi Kabashi - Kryesuese e Komunës  
BUDGETOJA E ADMINISTRATIVS PESËTITI  
OPERAVË SPOTË ADMINISTRATIVË

Dokumenti i kuvendit komunal  
Nr. 1-39  
Data 15.02.2022  
Përkatësia e kuvendit komunal



**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obilić - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic**

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.25.02.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Katarina Adjancic (SL).

**Të pranishmit tjere:** Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar i Komunës, drejtore komunal, përf. e KFOR-it zvicran, përf. i IZHL-së dhe qytetarët

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

**R E N D D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit komunal
4. Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.-I-36, e dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëminë e Tregtisë, Hotelierisë, Zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Obiliqit
5. Plotësim ndryshimi i Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Komunën e Obiliqit
6. Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021
7. Shqyrtimi i kërkeshave
8. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili me 18 vota për u miratua.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

**Sami Ahmeti** – Ne edhe përkundër vërejtjeve tona në seancën e kaluar ku kemi kërkuar që të respektohet Statuti i Komunës, për të evidentuar emrat e asambleistëve të cilët për ç kado që votojnë prapë procesverbalin na ka ardhë i njejtë dhe ne përsëri do të votojmë njejtë, do të votojmë kundër.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për, 7 vota kundër dhe 1 votë abstenim e miratuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Të gjithë e dini se Plani i punës i Kuvendit komunal është bazuar në LVL-në, neni 40.2, alinea 2, ku Kuvendi harton dhe miraton Planin vjetor të punës, e cila është një ndër kompetencat themelore të Kuvendit komunal. Anëtarët e Komisionit kanë punuar në bashkëpunim me drejtorët komunal, të cilët i kanë paraqitur disa Rregullore për shqyrtim gjatë vitit.

**Enver Gashi** – Ne e kemi lexuar me kujdes Draft Planin e Punës së Kuvendit komunal, nuk kemi ndonjë vërejtje dhe jemi për.

**Sami Ahmeti** – Ky Plan i Punës së Kuvendit komunal është copy paste i viteve të kaluara me disa ndryshime të temave, që do të bisedohen. Gjithsesi, ne e falenderojmë Komisionin për punën e bërë, por mendojmë se përveç mbledhjeve tona obligative që Komisioni me të drejtë i ka evidentuar do të duhej të kishim edhe disa aktivitete tjera, jo obligative psh seancë festive me rastin e datave të ndryshme, me rastin e Ditës së Mësuesit, Ditës së Nënave, Ditës së çlirimtë Komunës, Ditës së flamurit me prezencë të publikut. Mendoj se ne duhet të japim shembuj pak atraktiv sepse përkundër faktit që jemi me orientime të kundërtat politike, ne iu shërbejmë qytetarëve të njejtë dhe të gjithë do të ndjeheshim mirë kur ata vlerësohen për kontributin e tyre. Edhe njëherë jo për të nënvlerësuar punën e këtij Komisioni, por për të ia shtuar vlerën këtij plani ne propozojmë disa shtesa që bazuar në LVL-në, dhe Statutin e Komunës nuk i lejohen. Ne kemi vullnet të bëjmë këto plotësimë dhe grupi ynë është i gatshëm të kontribon. Mjafton ta dëshironi këtë, ne bëjmë një pauzë të shkurtë dhe i japim rekomandimet tona.

**Ajet Berisha** – Unë shohë se Komisioni për hartimin e planit të punës të Kuvendit komunal, nuk ka pasë kordinim me Drejtoritë. Normalisht Kuvendi nuk mund të funksionoj i vetëm sepse dalin obligime për Drejtoritë siç është aprovimi i Rregulloreve dhe unë minimalisht nga trajtimi i raportit vjetor kam parë se DSHPE-ja, thotë se shumë shpejtë 2 Rregullore do ti përfshijmë për aprovim, që tash nuk më kujtohet emri i atyre Rregulloreve. Mirëpo, nga raporti i punës e kam parë që ata e thonë dhe që në Planin e Punës nuk janë përfshirë. Do të thotë janë mangësi edhe pse sado formal ky plan është dashur minimalisht me u kordinue me Drejtoritë dhe me sektoret, ato që kanë plan Drejtoritë e që kanë të bëjnë me Kuvendin me u pasqyrue në këtë plan pune.

**Kryesuesja** – Ju e dini nga përvojat e mëhershme se plani i punës nuk është definitiv dhe mund të ketë ndryshime gjatë muajve në vijim, që është e paraparë edhe me LVL-në.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për 2 vota kundër dhe 6 vota abstenim e aprovuan planin e punës të Kuvendit komunal për vitin 2022.**

**Ajet Berisha** – Pavarësisht numrave që i keni mjaftueshëm ju, ishte një kërkesë nga grupi i LVV-së dhe as minimalisht nuk e trajtuat hiç. Kërkesa ishte për një pauzë dhe shqyrtim të këtij plani. Unë njerëzisht po ju lus që minimalisht kërkesat e secilit anëtar, që konsideroj se jemi të barabartë hudhe në votim bile. Në rast se nuk miratohet kërkesa është mirë të pyeten anëtarët tjerë a jeni për, a jeni kundër sepse ishte kërkesa e anëtarit të Kuvendit komunal.

**Kryesuesja** – Unë e hudha në votim punën e Komisionit dhe u aprovua, kështu që nuk kemi asgjë kundër se kemi kërkuar nga LVV-ja, me qenë pjesë e Komisionit dhe pasi që e kanë dhënë emrin e kanë tërheqë me vetëdëshirë.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për plotësim ndryshimin e Rregullores për fillimin dhe imbarimin e orarit të punës në lëminë e Tregtisë, Hotelierisë, Zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Obiliqit

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që kjo Rregullore të dalë në debat publik.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi që kjo Rregullore të delë në debat publik, mirëpo fillimisht kjo Rregullore kemi thënë në bazë të saj qysh na keni sjellë disa ligje ku iu referohet dhe këto ligje tashmë janë të shfuqizuara. Sigurisht se është dashtë me sjellë edhe një version të punës së juve çka ju mendoni që duhet me bë ndryshime. Përveç asaj kjo Rregullore e dt.25.02.2009, është e nënshkruar nga Burim Gërguri, që atëherë nuk ka qenë kryesues i Kuvendit komunal. Mund të jetë dëshira e tij me vendos nënshkrimin në

dokumente, por pastaj po përfundojnë në Gjykatë. E dyta, cili është qëllimi i kësaj Rregulloreje, a është penalizimi i subjekteve afariste, apo ndihmesa e tyre, çka ndryshon kjo te qytetarët, a është mbrojtja e punëtorëve sipas Ligjit të Punës, apo diçka tjetër. Pas marrjes së këtyre përgjegjeve, ne mund të japim kontributin tonë qoftë në debate publike, qoftë edhe në seancë.

**Ibush Mjekiqi** – Së pari kjo Rregullore e dt.25.02.2009, e nënshkruar nga Burim Gërguri, ai ka qenë kryesues i Kuvendit në vitet 2007-2009. Ne konsiderojmë se në këtë Rregullore duhet të bëhen disa ndryshime për arsyet të funksionimit të subjekteve afariste në territorin e Komunës tonë. Për të gjitha ndryshimet që do të paraqiten këtu, do të formohet një Komision i cili do ti shqyrton dhe po ashtu, edhe ju si annëtarë të Kuvendit, jeni të ftuar që ta jepni kontributin tuaj.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 6 vota abstenim e aprovuan Vendimin për plotësim ndryshimi e Rregullores nr.-I-36, e dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëminë e Tregtisë, Hotelierisë, Zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Obiliqit.**

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti plotësim ndryshimin e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Obiliqit.

**Enver Gashi** – Ne jemi për daljen në debat publik të Rregullores në fjalë.

**Sami Ahmeti** – Ne jemi gjithnjë që për debat publik të shkon Rregullorja, pastaj në vazhdim do ta japim kontributin tonë.

**Albana Shillova Shalaku** – Neve, po na intereson të dijmë deri tash se sa janë përmbushë përgjegjësitë e Këshillave lokale dhe drejtuesve të tyre që përcaktohen edhe me nenin 14, të kësaj Rregulloreje. Gjithashtu, në interes të publikut është se a janë kompensuar Kryetarët e këtyre Këshillave, që sipas nenit 13 të kësaj Rregulloreje kompensimi i tyre përcaktohet nga Kuvendi me vendim të veçantë.

**Ibush Mjekiqi** – Sqaron se është obligative formimi i Këshillave të fshatrave, por në mandatin e kaluar nuk i kemi formuar Këshillat e fshatrave për arsyet të pandemisë, kështu që nuk ka pasë kompensim. Në mandatin e kaluar është ndërrue ligji i cili e përcakton pagesën e Kryetarëve të Këshillave të fshatrave, kështu që deri më tani nuk është paguar jo vetëm në Komunën tonë, por edhe në Komunat tjera.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota për e aprovuan Vendimin për plotësim ndryshimin e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Obiliqit**

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – E falenderoj Kryetarin dhe Ekzekutivin për punën e palodhshme që e kanë bërë në vitin 2021, duke pasë parasysh sfidat e ndryshme si pandeminë që ka qenë diçka e re për vendet e zhvilluara e lëre më për Kosovën.

**Ibush Mjekiqi** – Ne e kemi bërë një raport të punës për vitin 2021, dhe të gjitha aktivitetet e vitit të kaluar janë pasqyruar në këtë raport. Besoj se e keni lexuar, mund tì jepni vërejtjet tuaja dhe ky raport mund të diskutohet, por nuk votohet.

**Enver Gashi** – Ne nuk kemi asnjë vërejtje, por mund të japim një falenderim për Kryetarin dhe Ekzekutivin për punën e palodhshme të tyre për këtë periudhë.

**Sami Ahmeti** – Ne realisht nuk kemi falenderim, por normal punën e vetë e kanë bërë. Megjithatë është një raport shumë voluminoz dhe është shumë i shkapërderdhur për dallim prej shumë fakteve ku do të duhej të cekën qoftë tarifat, qoftë gjithçka qysh është zhvillue. Raporti ka mungesa të mëdha, megjithatë ne me kërkesa do të iu drejtohem Drejtorive veç e veç për aty ku i kemi vërejtjet tona.

**Ajet Berisha** – Vërtetë, të shqyrtohet rapporti vjetor dhe të mos jetë prezantë Kryetari, kjo e pasqyron saktësisht joseriozitetin e krejtë punës. Sikurse edhe ky raport është jashtëzakonisht joserioz duke filluar jo nga vëllimi sepse është mjaftueshëm voluminoz, e që me një trajtim për ata që e kanë lexue dhe e kanë parë, unë jam i bindur që 50 %, të vëllimit më të vogël ka mund të pasqyrohet në mënyrën shumë më të mirë

puna e Komunës për vitin 2021. Do të thotë ka fjalë boshe, ka retorika, ka edhe lëvdata brenda vvetes nga sektore të ndryshme, ka pasaktësi, ka raportime të pasakta, ka elemente deri te dyshimet për pasqyrim finansiar jo të saktë, për raportim jo të saktë. Po ashtu, ka gabime drejtëshkrimore të jashtëzakonshme, ka edhe gabime teknike psh është Drejtoria që është dashtë të kujdeset, Drejtoria e Arsimit, ku fillon dhe përfundon fjalia pa asnje shkëputje. Është jashtëzakonisht vështirë edhe me lexue, e lëre më me trajtue dhe me u marrë seriozisht me këtë raport. Konsideroj se minimalisht kur të raportohet është dashtë me qenë prezentë Kryetari dhe kërkoj që kjo pike të shtyhet për një seancë tjeter, të bëhen përmirësime, të bëhen edhe rregullime teknike e përmirësime tjera. Në rast se nuk pranon ky Kuvend, unë do ti paraqes disa probleme që i ka ky raport, që konsideroj se janë probleme shumë serioze për një raportim para Kuvendit, e që i përbën ky raport. Në rast se nuk vendos Kuvendi me shtye këtë pikë të rendit të ditës për arsy që nuk është Kryetari dhe për arsy të problemeve që i ka raporti edhe teknike, unë do ti them disa fjalë për këtë raport edhe pse nuk meriton dhe nuk e ka qasjen serioze të raportimit. Mendoj se nuk meriton edhe me shpenzue kohë për me raportue për atë që këtu është paraqitë, jo për krejtë punët e kryera, por për pasaktësitë që janë të paraqitura në këtë raport nga sektorët e ndryshme të Komunës. Unë po e ndërpren fjalën në rast se ju kryesuese e hudhni në votim propozimin tim që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës. Në të kundërtën po e vazhdoj.

**Ibush Mjekiqi** – Së pari për neve është shumë serioz dhe nëse për z.Berisha, është joserioz është çështje subjektive e vlerësimit. Kryetari nuk është këtu sepse ka tjeter agjendë dhe nuk është i obliguar të jetë këtu.  
**Ajet Berisha** – Ju nuk e hudhët në votim propozimin tim se këtu, nuk vendos Nënkyryetari, por vendos Kuvendi dhe unë po e vazhdoj diskutimin tim për raportin.

**Ibush Mjekiqi** - Unë jam shumë i vetëdijshëm se nuk vendosi për këtë z.Berisha, por ky raport as nuk votohet, as nuk prolongohet.

**Kryesuesja** – Z. Berisha, për faktin se në fillim është votuar rendi i ditës dhe ky raport ka qenë në rend të ditës, atëherë Kuvendi nuk voton për raportin e Kryetarit.

**Ajet Berisha** - Unë po vazhdoj diskutimin rreth raportit për ato supozimet e mia për joseriozitetin, jo pasqyrimin e saktë të veprimeve dhe jo pasqyrimin e saktë të pasqyrave financiare nga DEFZH-ja. Pjesën e gabimeve teknike e keni parë edhe vetë kush e ka marrë mundin me lexue këtë raport voluminoz, që e thashë edhe më heret fillon dhe mbaron fjalia, askund nuk ndaher asnje fjalë. Ky është aspekt teknik, por dikush është dashtë të kujdeset që me na lehtësue punën dhe mos të përpinqemi ne me lexue dhe kuptue fjalinë pa u ndarë fjalët askund hiç , e nuk po flas për gabimet drejtëshkrimore. Unë po filloj te raporti dhe pasqyrimi finansiar, që nga buxheti i miratuar për vitin 2021, totali ka qenë mbi 11 milionë €, por praktikisht nga ai buxhet nuk figurojnë të hyrat 228 mijë dhe 743 mijë, nuk janë të pasqyruara si të hyra. Buxheti ka qenë i planifikuar 11,190.796 €, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara dikund 950,000 €, janë tejkalue 225,251 €, që në total bëjnë 11 milionë e 416 mijë e 47. Ndërsa në raportin që na keni ofruë buxheti është 11,644.790 €, që rezulton se 228,743.37 nuk i keni pasqyrue askund si të hyra. Edhe ne nuk dijmë se nga kanë ardhë dhe duke mos ditë se nga janë këto të hyra normalisht tash edhe te shpenzimi për mangësitë që janë bërë në raport edhe te këto i kemi dyshimet se nga kanë shkue. Fillimisht nuk e dijmë se nga kanë ardhë pastaj, nga raporti i shpenzimeve, ju vetëm raportoni për Drejtori duke mos specifikue llojin e shpenzimeve. Një element tjeter shumë i rëndësishëm është kur e pasqyroni shpenzimin e mallrave dhe shërbimeve, që është 1,128,000 €, edhe për subvencionet vlen e njejta, ju veç thoni administrata komunale ka shpenzue 149,000 €, inspeksioni 2,000 €, por ne është dashtë me pa se cili është lloji i shpenzimit se në mallra dhe shërbime hyjnë edhe shpenzimet e lloksit, derivate, që nuk janë të pasqyruara në raportin finansiar. Duke e kombinuar raportin e zyrtarit të Prokurimit dhe duke kombinuar raportin finansiar të shpenzimeve të pasqyruara nga DEFZH-ja, ju lus vetëm ta shikoni tabelën nga zyrtari i Prokurimit se përmes Zyres së Prokurimit janë shpallë tendere për mallra dhe shërbime dhe për investime kapitale për vitin 2021. Ju thoni se e keni bërë shpenzimin e buxhetit mbi 90 %, edhe pse te investimet kapitale është më pak 80 %, që tregon mungesën e kapaciteteve nga kjo Komunë për shpenzim të mjetve. Unë konsideroj se

këtë që ju thoni se keni shpenzu buxhetin 90 % nuk qëndron sepse në pasqyrat financiare, ju nuk i keni pasqyrue të hyrat saktë, që është problem shumë serioz. E para 228,000 €, ne nuk e dijmë se ku i keni marrë. E dyta, kur vjen te shpenzimi total Zyra e Prokurimit, thotë se përmes kësaj zyreje janë tenderue dhe janë shpenzue 3 milionë e 308,317 €. Për tenderim për vitin 2021, kanë qenë 6 milionë e 129,000 €, qysh ka mundësi me u shpenzue 90 % e buxhetit kur nga ajo që është dashtë me u tenderue është 6 milionë e 129,000 €, ndërsa nga Zyra e Prokurimit raportohet se janë shpenzue ose funksionalizue që është dikund pak më shumë se 50 %. Kjo tregon se reporti financiar i kësaj Komune është jo i saktë, nuk i tregon të hyrat saktë, nuk tregon llojin e shpenzimeve saktë, që ne të dijmë saktë se për cilat mallra dhe shërbime keni shpenzue më tepër. Këtu, ka edhe të pavërteta tjera psh në reportin e DSHMS-së, thuhet blerja e autoambulancës. Unë jam punëtor shëndetësor dhe minimalisht drejtoresha apo kush e ka bërë reportin, është edhe drejtori i QKMF-së këtu, është edhe punëtorja këtu si dëshmitare autoambulancë në vitin 2021, nuk kemi ble. Ndërsa, ju në reportin e DSHMS-së, e keni blerjen e autoambulancës me një vlerë të caktuar. Me kaq paturpësi me na mashtrue, ose thjeshtë me paraqitë në këtë report gjëra të pasakta, vërtetë kjo është mungesë e seriozitetit të jashtëzakonshëm, ose është nënçmim fillimi i anëtarëve të IQO-së, pastaj edhe neve të opozitës

**Kryesuesja** – Sipas Rregullores neni 33, fjala në kohëzgjatje prej 10 minutave mbaroi, kërkoi shumë falje.

**Ajet Berisha** - Saktësish na e tregon kohën e matjes, e ketë saktë dhe për këtë duhet me krijue besueshmëri dhe me paraqitë në monitor minutat kur i marrim, përndryshe nuk është që unë po besoj.

**Kryesuesja** – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

**Ajet Berisha** – Kryesuese, më fal unë kam ngritë çështje që kërkojnë sqarim. Unë e di që reporti nuk votohet, por ju nuk mund ta mbyllni pa i sqarue këto pasaktësi që i ngrita.

**Kryesuesja** – Z.Berisha, ne fillimi i thamë se reporti i Kryetarit nuk votohet dhe ju vetë pyetët, vetë u përgjegjët.

**Sami Ahmeti** – Unë besoj se një shpjegim prej Nënkyetarit për pikat e ngritura do të ishte mirë dhe nuk do të ishte e tepört.

**Ibush Mjekiqi** – Unë fillimi i thashë se ky report nuk votohet, por vetëm reportohet dhe pretendimet që i ngriti z.Berisha, janë pretendime të tij. Raporti i shpenzimeve, që e the më se 90 %, është shumë i saktë dhe nuk mund të jetë jo i saktë. Për të gjitha çështjet që i ngrite ekziston auditimi i brendshëm dhe të gjitha ato që ju i thatë dalin se a janë të sakta, apo nuk janë të sakta. Unë e them me përgjegjësi të plotë se ke ngritë çështje që nuk janë të sakta dhe gjithçka që është punuar në vitin 2021, është këtu e pasqyruar. Sa i përket autoambulancës që e përmende, nuk është e vërtetë që nuk është ble por kodi buxhetor është i tillë që shkruan blerja e autoambulancave dhe veturave. Vija buxhetore ashtu ka qenë dhe ka mbetë edhe këtë vit dhe ka me vazhdue sepse kemi nevojë përfurnizim me vetura dhe autoambulanca për nevojat e QKMF-së dhe QPS-së. Prandaj gjithçka në report është e saktë dhe jo e pasaktë.

**Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga kompania Berisha Group, sh.p.k. për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore. Kjo kërkesë është shqyrtuar edhe në KPF, dhe si rekondit kemi që kjo kërkesë të iu dërgohet për shqyrtim Drejtoreve përkatëse. Përgjegjja e DPUKP-së, është që kjo kërkesë të tërhiqet nga rendi i ditës, për arsy se duhet konsultim nga Agjensioni kadastral i Kosovës. Prandaj, kjo kërkesë tërhiqet nga rendi i ditës derisa të vjen Drejtoria me dokumentacion të kompletuar dhe sqarim me shkrim lidhur me këtë kërkesë.

Po ashtu, kemi edhe një kërkesë nga N.SH. "Kastrioti" sh.p.k. për ndihmë financiare për arsyet e pandemisë covid 19.

**Ibush Mjekiqi** – Ne mendojmë se Kuvendi duhet të merrë një vendim për subvencionimin e të gjitha kompanive në Komunën tonë në shumën prej 15,000 €. Kjo shumë e mjeteve do të menaxhohet në bazë të një thirrje të kompanive që bëjnë transportin publik në Komunën tonë, që të përfitojnë prej kësaj shume të mjeteve për shkak të irritjes së çmimit të derivative.

**Enver Gashi** – Ne jemi për me iu ndihmues, por a jeni konsultue me ligjin se a kemi të drejtë ne si Kuvend të iu ndihmojmë këtyre kompanive. Është shumë e vërtetë se kanë nevojë për ndihmë sepse këto kompani në kohën e pandemisë kanë operue ndoshta me shumë humbje dhe jo me ndonjë fitim.

**Sami Ahmeti** – Realisht kërkesa nuk duket se është kërkesa zyrtare, fillimisht kërkesa tjetër, janë të protokoluara nga kush ka ardhë dhe kanë hyrë këtu brenda. Përveç asaj, për Kuvendin komunal, Burim Gërgurin, kryesues pastaj, Nënkyetari thotë ti ndajmë 15,000 €, por këta nuk e kanë kërkuar këtë shumë. Nga forma e zhvillimit të këtij diskutimi po duket se ne po veprojmë diçka çka edhe vetë pala nuk ka kërkuar. Fillimisht kërkesa nuk i plotëson kushtet, nuk dihet se çka ka kërkue përvëç që ka kërkue ndihmë financiare. Mirëpo, ndihmë financiare mund të janë edhe 100 €, munden me qenë edhe 100,000 €, kështu që besoj se kërkesa nuk i plotëson kushtet që të hudhet në votim. Gjithsesi, ju e dini mundeni me vazhdue, ne jo që jemi kundër për me i mbështetë, përkundrazi jemi për me i mbështetë sepse vetëm këtu rritet zhvillimi ekonomik. Megjithatë, nuk jemi për me marrë vendime paushalle hajt po ia jepi 10,000, hajt po ia jepi 15,000 sepse jemi institucion i rendësishëm.

**Kryesuesja** – Sqaron se kërkesa është e protokoluar, por te ju ka ardhë pjesa tjetër, që ndoshta është lëshuar një gabim nga zyra pritëse. Unë sa kuptova Nënkyetari nuk kërkoi që 15,000 €, ti jepen vetëm kësaj kompanie, por të ndahen për të gjitha kompanitë që operojnë në Komunën e Obiliqit.

**Ibush Mjekiqi** – Ligji për rimëkëmbjen ekonomike e lejon subvencionimin e subjekteve afariste dhe për shkak të situatës që ka mbretëruar, që fatkeqësisht po vazhdon ende të mbretëroj në territorin e Komunës tonë dhe më gjerë. Shuma e mjeteve prej 15,000 €, nuk do ti jepet vetëm një kompanie, por do ti mbështetim të gjitha kompanitë e transportit publik në Komunën tonë. Ju e dini se Kuvendi ka marrë vendim për subvencionimin e të gjithë atyre që preken me covid me 100 €, dhe ky vendim është vazhdimësi. Vendimet janë të drejta dhe nuk shkelen ligjet në fuqi

**Ajet Berisha** – Mendoj se fillimisht drejtoresha e DEFZH-së, është dashtë me na svarue sepse kërkesa e kësaj kompanie jo vetëm e kompanive të transportit për mua është e drejtë sepse shteti, Komuna, institucionet tona i kanë detyruar përvende të kufizuar këto kompani për transport. Në momentin që i detyron se nuk guxon me i pasë 50, por ke me pasë 50 % të hapësirës me shfytëzue për shkak të pandemisë, mendoj se shteti është dashtë me mendu me subvencionu. Këta, në kërkesen e vet thojnë kompanitë ndërkomunale apo transportuese ndërkomunale janë subvencionue nga Qeveria, që praktikisht po nga aspekti ligjor transport urban në Komunën e Obiliqit nuk kemi. Është dashur me u subvencionue secila kompani që është duke funksionue në Komunën e Obiliqit, sepse në bazë të ligjit transporti urban do të thotë organizim i transportit brenda vijave komunale, bille urban është saktësishët brenda qytetit.. Në bazë të ligjit urban periferik, do të thotë edhe fshatrave, ndërsa në rast se secila kompani funksionon duke bërë transportin prej një Komune në një Komunë tjetër, atëherë ky quhet transport ndërurban. Propozimi i Nënkyetarit, ashtu qysh e njohë është me shabllonin po i ndajmë 15,000 €, dhe kur të vjen koha ia japid ngapak, që mendoj se është pa kurrfarë analize veç i ra në mend dhe ta them një vlerë. Mendoj se DEFZH-ja, bashkë me DSHPE-në me pasë një analizë se sa është dashur me iu dalë në ndihmë të gjitha këtyre kompanive në rast se nuk janë subvencionue nga Qeveria, sa është analizue se janë ato dëme dhe sa ka kapacitet Komuna me i mbështetë dhe me ardhë me propozim. Mirëpo, jo ad-hoc këtu, jo këtij s'po i ndihmojmë por të gjithëve 15,000 €. Mendoj se është jo shumë serioze kjo dhe propozoj që për mbledhjen e radhës me një analizë nga Ekzekutivi i Komunës, të vjen me propozim konkret dhe me informata se a është subvencionue dikush apo jo, që ne të jemi më të informuar dhe më të saktë për atë që dojmë me votue.

**Ibush Mjekiqi** – Propozimin nuk e kam këtu, por propozimin e kam në bazë të asaj që kemi analizue dhe kemi marrë qëndrim që në këtë mbledhje ta paraqesim në bazë të kapacitetit buxhetor vlerën prej 15.000 €. Unë nuk e thashë këtu për këtu, por z.Berisha ma lexoj mendjen se çka jam duke mendue. Mendoj se sot të merret vendim për fondin prej 15,000 €, pastaj menaxhohet pëmës DSHPE-së sepse ata e dijnë sa autobusa janë, do të thotë bëhet një formulë dhe mjetet ndahen në mënyrë të barabartë për të gjitha kompanitë.

**Ajet Berisha** – Unë nuk thashë që propozimi për një shumë të caktuar nuk duhet me qenë dhe unë nuk thashë se sot duhet me vendos ne për kërkesën, përkundrazi. Sikur të kishte pasë një analizë ky Ekzekutiv nuk është për me i ra në mend Nënkyetarit 15,000 €, por kishte me ardhë me letër dhe kishte me thënë në bazë të kësaj kërkesë, në bazë të analizave, në bazë të subvencionimit të Qeverisë, në bazë të planifikimit tonë buxhetor janë 15,000 €, për këtë punë. Mirépo, këtij i ra në mend aty për aty sepse as se keni përmendë këtë punë sepse po të kishte qenë e përmendur do ta thoshit edhe në KPF. Ju si rekomandim e keni sjellë kërkesën, pse nuk e keni shqyrtue në KPF, meqë jeni marrë me këtë kërkesë. Unë jam i sigurtë se Nënkyetarit i ra në mend vetëm aty, shuma dhe hajt si po ia bëjmë.

**Ibush Mjekiqi** – Kërkoj falje z.Ajet Berisha, për sigurinë tënde që e thua në raport dhe a më ra në mend, apo s'më ra në mend është çështje e jotja. Unë kam qenë në KPF dhe prej datës kur është mbajtë KPF-ja, e deri sot jemi marrë me atë temë dhe kjo është arsyaja që e propozova.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për, 3 vota kundër dhe 5 vota abstenim e aprovuan Vendimin për subvencionimin e kompanive private që operojnë në linjat e transportit publik urban dhe ndërurban në territorin e Komunës së Obiliqit.**

**Sami Ahmeti** – Unë e di se ka ardhë një kërkesë nga znj.Xhevahire Preniqi, me dt.23.02.2022, do të thotë pasi që ka ardhë rendi i ditës, një kërkesë për ndihmë për një fëmijë që e ka për nevoja të veçanta. Kërkesa është tentue ti drejtohet Drejtorisë së Arsimit, por Drejtoria e Arsimit nuk e ka pranue sepse fëmi është me ngecje dhe ka nevojë për psikologë, për mjete të shumta për me ia lehtësue jetën. Megjithatë, do të ishte shumë e rëndësishme që ta trajtojmë edhe këtë kërkesë sepse ky fëmi është fëmi i veteranit të UÇK-së dhe mbi të gjitha nuk kanë asnë të hyrë tjetër përvëç pagës së veteranit. Unë e di se kërkesa ka ardhë me vonesë dhe Kuvendi ka të drejtë që se ka përfshi në rend dite, megjithatë mendoj se është humane me trajtue këtë kërkesë sepse një muaj për të është shumë.

**Ibush Mjekiqi** – Unë jam në dijeni për këtë kërkesë sepse sot ka qenë temë e trajtimit në Këshillin e drejtorëve dhe Drejtoria e shëndetësisë dhe e Arsimit, do të merren me këtë kërkesë. Ne brenda javës së ardhshme do ta kemi një qëndrim lidhur me këtë kërkesë dhe nuk ka nevojë që në këtë seancë të futet në Kuvend.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Labinot Mirena** – Dua ta prezentoj një shqetësim të shumë qytetarëve lidhur me orarin e autobusëve në Komunën tonë, për mungesën e shtrirjes së transportit në të gjitha fshatrat. Kërkoj nga Drejtoria e inspeksionit që ta përcjellë orarin e çdo linje të autobusëve, se sa po e respektojnë ata sepse qytetarët presin prej 20 - 30 minuta dhe nuk vjen asnë autobus. Pastaj, në të njëjtën kohë vijnë 2 autobusë, ndërsa vikendeve nuk respektohen oraret e autobusëve hiç. Të dielën nuk ka linja të autobusëve nëpër fshatra edhe pse qytetarët punojnë edhe ditëve të diela.Kërkoj që të shqyrtohet mundësia në stacione të paraqitet orari i linjave të autobusëve në formën digjitale, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar saktë me orar dhe linja. Po ashtu, propozoj të ketë shtrirje të linjave edhe në fshatrat ku nuk ka momentalisht linja të autobusëve si në Baimoc, Raskovë, Bakshi, Llazarevë, Mazgit i Epërm, Mazgit i Ulët, Grabofc, Shipitullë dhe Hade. Në kohën e fundit është edhe ngritja e

çmimit të biletave. Unë pajtohem se kanë qenë në kushte të vështira kompanitë e transportit, por ngritjen e çmimit të biletave nuk e di me

çfarë arsyetimi po e bëjnë sepse nëse, kur ishte litra e naftës 1 €, e 40 centë biletat kanë qenë 80 centë, kur u bë litra e naftës 89 centë biletat kanë mbetë 80 centë. Pra, të shikohet mundësia mos të rritet çmimi i biletës për qytetarë dhe të gjendet mundësia për subvencionimin e tyre, nëse nafta është e shtrenjtë. Kjo është kërkesa ime që mu kanë adresue shumë qytetarë dhe në kontakt edhe me kolegut z.Jeton, kemi pasë takim me qytetarë të atyre zonave, të cilët kanë kërkuar me iu bë zgjidhje për transport.

**Jeton Mjekiqi** – Sa i përket kërkesës së z.Labinot, është e vërtetë se kemi pasë 5,6 kontakte, unë vetë vijë prej atij fshati. Ne jemi munduar edhe më heret me bë njëfarë marrëveshje, por s'kemi mund me bë me Fushë Kosovën, nuk iu kanë përbajtë. Problemi është se edhe nxënësit tonë nga Grabofci më shumë janë

të fokusuar nga Fushë Kosova dhe Prishtina, se sa nga Obiliqi. Prandaj, është mirë që të bëhet një zgjidhje në këtë drejtim.

**Sami Ahmeti** – Edhe pse Kryetari nuk është këtu, ne jemi dëshmitarë të një ngjarje që e kanë publikuar mediat në fillim të kësaj javë, ku thuhet që Kryetari i Komunës ka thyer rregullat e pandemisë duke qëndruar në orë policore në kafe, pastaj gjithnjë sipas.....

**Kryesuesja** - Sipas nenit 50, pika 2, gjatë debatit nuk janë të lejuara shprehjet ofenduese, nënçmuese dhe paraqitja e të dhënavë ngajeta private e askujt.

**Sami Ahmeti** - A ka mundësi të na tregoni cila ishte fjala fyese apo ofenduese që unë e përdora?

**Kryesuesja** - Ju filluat të diskutoni që ka ba shkelje, ajo është çështje personale e tij, thashë ngajeta private.

**Sami Ahmeti:** Çështje personale është kur bëhet fjalë për një person privat, Kryetari është person publik, ai iu raporton qytetarëve dhe duhet të jetë shembull i respektimit të ligjit, megjithatë nëse ju e vlerësoni kështu dhe deri sa i njëjti nuk është këtu, atëherë vazhdojmë, s'ka problem!

**Kryesuesja:** Faleminderit, me kaq e mbyllim seancën e sotme.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:04'**

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli



**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

**Vlora Mjekiqi Kabashi**